

VENDIM
Nr. 19, datë 10.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare gjyqësore Belma Lleshi, në datën 10.3.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 6, Akti, që i përket:

KËRKUES: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Bashkim Dedja

OBJEKTI: Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha.

BAZA LIGJORE: Nenet 127/b dhe 127/2 të Kushtetutës, nenet 8/3 dhe 9/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatimin e bërë nga Kryetari dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

VËREN:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 5614, datë 11.2.2008, ka emëruar znj. Vitore Tusha anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 158, datë 18.2.2008, ka dhënë pëlqimin për emërimin e znj. Tusha si anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

Në datën 10.3.2008 znj. Tusha ka bërë betimin para Presidentit të Republikës. Sipas nenit 8/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se *mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji, të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*. Për rrjedhojë, data 10.3.2017 konsiderohet data e mbarimit të mandatit të znj. Vitore Tusha.

Në përputhje me nenin 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenin 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se, mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari paraqiti para kësaj Gjykate kërkesën për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 127/b dhe 127/2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Vitore Tusha në datën 10.3.2017.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj,
Fatos Lulo, Besnik Imeraj